



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.767/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Burim Ademi dhe Ferki Xhaferi anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Edona Grajçevci, duke vendosur lidhur me apelin e Saranda Musliu nga Ferizaji, kandidatija për deputet nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të datës 04.03.2021, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet i parregullt apeli Anr.767/2021, i datës 05.03.2021, i parashtruar nga Saranda Musliu nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në komunën Ferizaj parashtruesja nuk ka theksuar ndonjë parregullsi por vetëm ka bashkangjitur një deklaratë, dhe nuk e ka nënshkruar formularin e ankesës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që janë mbajtur më datë 14 Shkurt 2021.

A r s y e t i m

Me datë 05.03.2021, PZAP-i ka pranuar një apel të parashtruar nga Saranda Musliu nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në komunën Ferizaj, Në apelin e saj parashtruesja nuk ka theksuar ndonjë parregullsi por vetëm ka bashkangjitur një deklaratë, dhe nuk e ka nënshkruar formularin e ankesës.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së apelit gjeti se:

Apeli është i parregullt

Paneli, nga shkresat e lëndës vlerësoj se apeli i paraqitur nga Saranda Musliu, është i parregullt, sepse apeli në fjalë nuk i plotëson kërkesat ashtu siç parashihet me nenin 10.7 të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, ku theksohet se: *“Personi që e dorëzon apelimin duhet të përdorë formularin e gatshëm për apelim”*. Të gjitha apelimet duhet të kenë së paku informacionet vijuese:

- a) *emrin, adresën dhe informacionet per kontaktim të personit që e dorëzon apelimin*
- b) *arsyen për dorëzimin e apelim*

- c) *hollësi rreth çfardo dëshmie dhe kopje të çfardo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të personit që e dorëzon apelimin apo udhëzimin se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk ajnë në posedim të parashtruesit të apelimit*
- d) *vërtetimin nga personi që e dorëzon apelimin lidhur me vërtetësinë e përmbajtjes së apelimit.*

Prandaj Paneli, nuk u lëshua fare në meritat e apelit, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartëcekur.

Nga arsyet e lartëcekura e në mbështetje të nenit 10.7 të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.767/2021 më datën 06.03.2021.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.